



Pranimi / Received Prilaps / Attached Kuvend / Assembly	19.01.2022	2	viti / year
Organ / Institution Org. / Inst.	SKMYSHX	248/2022	115
Shprehja / Expression Shprehje / Expression			
Sasia / Quantity Kopjime / Copies			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. nr.1229/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga; Ardita Haxhnikaj Demi -kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.51/2020 të datës 28.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.726/2019 të datës 21.11.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë Prishtinë, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.726/2019 e datës 21.11.2019, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 21.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5477/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër 14-111/01-0263245/19 të datës 28.10.2019 si dhe Njoftimit me numër 14-111/01-284561/2019 të datës 19.11.2019, lidhur me Konkursin me numër 14-11/01-228044/2019 të datës 17.09.201, të shpallur nga Komuna e Prishtinës për pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Kulturë”, për shkak të shkeljes së Ligjit Nr.06/L114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.11.2019 ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli me datë 15.12.2020, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.01.2020 përmes shkresës me numër protokollit 25/2020, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës me numër A.nr.726/2019 të datës 21.11.2019, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë gjyqësore në gjykatën kompetent gjegjësisht Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 28.12.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.51/2020, me të cilin ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të datës 08.01.2020, duke e obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 21.11.2019.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova;** Ankesën e datës 21.11.2019 me numër të protokollit 5477/2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Padinë e datës 23.09.2019 të parashtruar nga ankuesi në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Shpalljen e konkursit të datës 17.09.2019 me numër 14-111/01-2280044/19; Njoftimin me numër 14-111/01-284561/19 të datës 19.11.2019; Listën e ngushtë me numër 14-11/01-0263245/2019 të datës 28.10.2019; E-mailin e datës 23.10.2019; Kërkesën për Përgjigje në ankesë të datës 26.11.2021 me numër të protokollit 5528/2019; Njoftimin me numër të protokollit 25/2020 të datës 08.01.2022; E-mailin e datës 04.06.2020; E-mailin e datës 08.12.2020; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3148/2020 të datës 15.12.2020; Kërkesën për punësim me numër 14-111/01-0233759/19 të datës 23.09.2019 të ankuesit

Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.12.2016; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.12.2017; Diplomën universitare të datës 14.01.2008 të kandidatit Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Kontabiliteti dhe legjislacionin e ri tatimor, deklarata vjetore dhe pasqyra financiare" për muajin qershor vitin 2019; Certifikatën e datës 19-27.11.2018; Vërtetimin 01 nr.119-112 të datës 26.08.2019; Shpalljen e konkursit për avancim të brendshme të datës 12.03.2019 me numër 14-111/01-228044/19; Autorizimin e Ministrisë së Administratës Publike të datës 11.09.2019; Vendimin me numër 14-020/04-253359/19 të datës 15.10.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës të shërbimit civil; Listën e ngushtë e datës 28.10.2019; Listën e kandidateve të cilët kanë dorëzuar aplikacionet Form.MAP-SHCK-04; Listën e datës 30.10.2019 lidhur me vlerësimin e aplikacioneve dhe përfshirjen e kandidateve në listën e ngushtë; Renditjen përfundimtare të Kandidateve Form.MAP-ShCK-10; Përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 28.10.2019 Form.MAP-SHCK-05; Kërkesën për punësim të datës 24.09.2019 me numër 14-11/01-0234915/19 të kandidatës

Vërtetimin me numër 01. Nr.119-101e datës 20.09.2019; Dokumentin e identifikimit të kandidatës

Certifikatën e datës 05-06.05.2016 të kandidatës lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Komunikimi dhe Hartimi i Shkresave në Administratën Publike"; Certifikatën e datës 29-31.05.2019; Certifikatën e datës 13.09.2010-09.02.2011; Certifikatën e datës 24.06.2010; Diplomën e datës 09.01.2004- 16.04.2004; Diplomën universitare të datës 12.05.2010 të kandidatës Diplomën universitare të datës 02.11.2018 të kandidatës

Vlerësimin Individual të kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj për kandidaten Form.MAP-SHCK-08a; Testin me shkrim të datës 30.10.2019 të kandidatës Përmbledhjen e vlerësimeve individuale Form.MAP-SHCK-09; Raportin final të rekomandimit të Komisionit Rekrutues të datës

06.11.2019, Form.MAP-AHCK-11; Vlerësimin individual të kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidaten Form.MAP-SHCK-08a; Kërkesën për punësim e ankuesit e dorëzuar në post me datën 25.09.2012 dhe pranuar në Burimet njerëzore në Komunën e Prishtinës me datën 27.09.2019 Form.MAP-SHCK-03; Përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushte të datës 28.10.2019 Form. MAP-SHCK-05; Kërkesën për punësim të datës 24.09.2019 me numër 14-111/01-0235031/2019 të kandidates Vërtetimin e datës 20.09.2019, me numër 01.nr.119-100; Dokumentin e identifikimit të kandidates Certifikatën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për kandidaten të datës 22.10.2000 me NR.04956/4; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 për kandidaten Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për kandidaten Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2015 për kandidaten Formularin për vlerësimin e përbushjes së detyrave për periudhën kohore 01.01.2013-31.12.2013; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për kandidaten Vendimin për përcaktimin e ushtruesit të detyrës me numër protokollit 14-112/02-185476/201 të datës 30.07.2019; Vendimin për përcaktimin e ushtruesit të detyrës të datës 08.05.2019; Vendimin për caktimin e ushtruesit të detyrës të datës 12.02.2019 me numër 14-112/02-32077/19; Vendimin për caktimin e ushtruesit të detyrës me numër 14-112/02-278876/18 të datës 22.11.2018; Letrën e rekomandimit për të datës 23.09.2019; Certifikatën e datës 19.09.1997; Certifikatën e periudhës kohore 10.06.2008-21.01.2009 e lëshuar për kandidaten me trajnimin " Trjanimi Profesional për të drejtat e njeriut; Certifikatën e datës 22-30.10.2018; Certifikatën e datës 26.06.2013; Certifikatën e datës 06.04.2010; Shkresën me të cilën vërtetohet se kandidatja ka marre pjesë në Programin trajnues për anëtarët e shoqërisë civile; Certifikatën e vitit 2003; Mirënjohjen për kandidaten lidhur me kontributin e dhëne në temën " Dhuna ndaj Grave"; Certifikatën e kandidates lidhur me pjesëmarrjen dhe përfundimin e suksesshëm të trajnimit profesional për të drejtat e njeriut; Certifikatën e kandidates për pjesëmarrjen e suksesshme 3-ditor të mbajtur me 1,2,3 dhjetor 2015; Vendimin e datës 17.04.2008 për themelimin e njësisë për të drejtat e njeriut; Përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushte të datës 28.10.2019 Form.MAP-SHCK-05; Kërkesën për punësim të datës 23.09.2018 me numër 14-111/01-233837/19 të kandidates Vërtetimin e datës 23.09.2019 me numër 01 nr.119-115; Diplomën e datës 15.05.1990 me numër 7151 të kandidates Certifikatën e datës 04.04.2008; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.12.2018 për ankueser Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë te datës 26.12.2017 për ankuesen Dokumentacionin e identifikimit të ankueses Vërtetimin e datës 18.09.2019 me numër 21/19; Përcaktimin e kritereve për përfshirjen në Listën e ngushtë për kandidatit Form.MAP-SHCK-05; Kërkesën për punësim me numër 14-111/01-234395/2019 të datës 24.09.2019 të kandidatit Vërtetimin me numër 01-nr.119-113 të datës 23.09.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 05.02.2013 për kandidatit Diplomën universitare të datës 26.04.2006 të kandidatit Dokumentin e identifikimit të kandidatit Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.12.2017 të kandidatit Kërkesën për punësim me numër 14-11/01-234382/2019 të datës 24.09.2019 të kandidates Vërtetimin me numër 01.nr.119-114 të datës 23.09.2018; Dokumentin e identifikimit të kandidates Certifikatën me Nr.04-1546/551 e datës 06.07.2004; Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.12.2017; të kandidates Formularin e vlerësimeve të rezultateve në punë të datës 28.12.2018 të kandidates Formularin për vlerësimin e përbushjes së

detyrave për periudhën kohore 01.01.2013-31.12.2013 për kandidaten  
e punës për periudhën 01.01.2014-31.12.2014; Emalin e datës 15.12.2020.

Planin

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të  
parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse;*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se Komuna e Prishtinës, sipas Autorizimit të datës  
11.09.2019 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil, me datë 17.09.2019 ka shpall  
Konkursin për Avancim me numër reference 14-111/01-228044/19 për pozitën e punës "Udhëheqës  
i Sektorit për Kulturë". Konkursi ka qenë i hapur nga data 17.09.2019 deri 24.09.2019, dhe nga provat  
e lëndës nuk vërehet se ka pas zgjatje të afatit lidhur me konkursin në fjalë.

Në këtë pozitë kanë aplikuar gjithsej nëntë kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin, ndërsa në listën  
e ngushtë të datës 28.10.2019, nuk është përfshirë ankuesi me arsyetimin se nuk ka plotësuar  
kushtet e konkursit.

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi ka aplikuar përmes postes  
me datë 25.09.2019, ndërsa aplikacioni është pranuar me datë 27.09.2019 nga Zyra e Personelit në  
Komunën e Prishtinës, pra dy ditë pas mbylljes së konkursit në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në  
Shërbimin Civil, përkatësisht nën 22 paragrafit 2 ku përcaktohet se: *Aplikacionet e pranuar pas  
afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare ose çfarëdo dëshmie tjetër për  
datën e dërgimit, dëshmonë se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, dhe duke  
marr parasysh se edhe në konkursin në fjalë ceket se: Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të  
pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim, Kolegji për Shqyrtimin e  
Ankesave, konstaton se Komisioni Përzgjedhës i themeluar me Vendimin nr.14-020/04-253359/19  
të datës 15.10.20219 për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Kulturë", me rastin e refuzimit të  
aplikacionit të ankuesit dhe mos përfshirjen e tij në Listën e Ngushtë, ka vepruar në pajtim me nenin  
22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe  
rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.*

Kështu që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën  
paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e  
Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij  
Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike;** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i  
Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në  
Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita  
në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e  
këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me A.nr.1229/2021,

Ilire Mehmeti -Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

